

Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

Projekt për konkurrencën lokale dhe rajonale në Republikën e Maqedonisë

**Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)**

---

Projekt për konkurrencë lokale dhe rajonale në Maqedoni

**19/10/2015**

## 1 Përmbajtja

---

PARATHËNIE .....	4
LISTA E NOCIONEVE .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Rezyme ekzekutive .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
1. Hyrje .....	9
1.1 Të dhëna themelore për Projektin .....	9
1.2 Arsytim për hartimin e Kornizës së Politikave për Zhvendosje .....	10
1.3 Ndikime të pritshme .....	11
1.4 Qëllimet dhe parimet e politikave për zhvendosje .....	12
1.5 Procedura e hartimit dhe miratimit të Plan Veprimit për Zhvendosje .....	12
1.5.1 Plan Veprimi për Zhvendosje .....	12
1.5.2 Skrining procesi për zhvendosje (eksproprijimi i tokës) .....	13
2 Korniza institucionale dhe juridike .....	14
2.1 Korniza institucionale .....	14
2.2 Korniza juridike .....	15
2.2.1 Procesi i eksproprijimit .....	16
2.3 Parimet dhe procedurat për zhvendosje të Bankës Botërore të aprovuara me këtë Plan Veprim për Zhvendosje .....	18
2.4 Analizë e boshllëqeve – legjislacioni maqedonas për eksproprijim dhe politikat mbrojtëse të Bankës Botërore .....	19
3 Përshtatshmëria dhe autorizimet .....	22
3.1 Persona të kualifikuar të prekur me Projektin .....	22
3.2 Të drejta .....	23
3.3 Vlerësimi i asetëve të prekura .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.4 Vlerësimi i zëvendësimit .....	256
4 Kërkesa për informatat në Plan Veprimin e Shkurtuar për Zhvendosje .....	26
4.1 Regjistrimi dhe inventari i personave të prekur nga Projekti .....	267
4.2 Identifikimi i humbjeve .....	277
4.3 Hulumtimi bazik .....	278
5 Zgjidhjet për zbatim .....	278

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

5.1	Zhvillimi dhe procesi i miratimit të Plan Veprimit për Zhvendosje .....	27
5.2	Procesi i zbatimit të Plan Veprimit për Zhvendosje.....	28
6	Mbikëqyrja dhe monitorimi.....	31
7	Pjesëmarrja e njerëzve .....	32
8	Shpenzime dhe buxhete .....	32
	Aneksi 1: Matrica për të drejtën e përkohshme dhe kompensim .....	32
	Aneksi 2: Lista për kontrollin e informatave nga regjistrimi.....	33
	Aneksi 3: Lista e të dhënave për hulumtim nga regjistrimi .....	345
	Aneksi 4: Lista e të dhënave për regjistrimin e humbjeve .....	35
	Aneksi 5: Të dhëna për sondazhin bazik.....	378
	Aneksi 6: Ligji për eksproprijim – tekst i konsoliduar.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b> 40

### ***PARATHËNIE***

---

Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH), e cila i përshinë çështjet e zhvendosjes dhe blerjes me detyrim të tokës është hartuar nga Kabineti i Zëvendëskryeministrit për Çështje Ekonomike – institucion i caktuar si Agjenci për implementim. Ky është njëri nga dokumentet kyç të Projektit për konkurrencë rajonale dhe lokale të turizmit (RLCT) të financuar nga IPA fondet e BE-së, ndërkaq i zbatuar nga Banka Botërore. Masat tjera mbrojtëse, korniza për menaxhim me mjedisin jetësor dhe planet përkatëse për menaxhim me mjedisin jetësor janë pasqyruar në Manualin Operativ (MO). Kjo KPZH është një dokument i cili e plotëson MO. Ky dokument i merr parasysh qasjet dhe politikat e blerjes së tokës dhe zhvendosjes, të cilat i ka kërkuar Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Banka Botërore, si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Dokumenti i përpiluar nga RLCT siguron një kornizë për sigurimin e harmonizimit me kërkesat e të gjitha palëve me mirëkuptim se do të zbatohen kërkesat më të rrepta të cilësdo qoftë palë. Kjo kornizë e politikave për zhvendosje është elaboruar për Projektin e konkurrencës rajonale dhe lokale të turizmit, i financuar nga BE. Projekti ka më shumë komponentë të cilët fokusohen në mbështetjen e ofertës turistike në infrastrukturë që ka të bëjë me turizmin (sinjalistikë, rrugë, qendra të vizitorëve, vend-parkime) dhe lokacionet e trashëgimisë kulturore.

***Shkurtesa***

---

APMT	Agjencia për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit
PVSHZH	Plan Veprimi i Shkurtuar për Zhvendosje
KZKÇE	Kabineti i Zëvendëskryeministrit të Çështje Ekonomike
QRM	Qeveria e Republikës së Maqedonisë
ZHD	Zhvendosje e detyrueshme
PKLR	Projekt për konkurrencë lokale dhe rajonale
MK	Ministria e Kulturës
ME	Ministria e Ekonomisë
MVL	Ministria e Vetëqeverisjes Lokale
MTL	Ministria e Transportit dhe Lidhjeve
OJQ	Organizata joqeveritare
GZRM	Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë
PPP	Persona të prekur nga Projekti
NJZP	Njësia për Zbatimin e Projektit
NJZZH	Njësia për Zbatimin e Zhvendosjes
RM	Republika e Maqedonisë
KPZH	Korniza e Politikave për Zhvendosje
PVZH	Plan Veprimi për Zhvendosje
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
BB	Banka Botërore

### ***LISTA E NOCIONEVE***

---

Plan Veprimi i Shkurtuar për Zhvendosje (PVSHZH): është dokument planor i cili përshkruan çka do të bëhet që t'u përgjigjemi ndikimeve të drejtpërdrejta sociale dhe ekonomike që kanë të bëjnë me zhvendosjen e detyrueshme apo me eksproprijimin e tokës. Ky nocion aplikohet aty ku personat e prekur nga Projekti janë më pak se 200.

Institucioni shfrytëzues: ESP bazohet në Kabinetin e Zëvendëskryeministrit për Çështje Ekonomike. ESP është Agjenci e zbatimit e cila, gjithashtu, do të sigurojë grante dhe investime për institucionin-shfrytëzues, e që do të jetë komunë apo cilado qoftë agjenci tjetër kompetente për pranimin e grantit investues për infrastrukturë. Në pjesën më të madhe të rasteve institucioni-shfrytëzues, i cili do ta kryej eksproprijimin do të jenë autoritetet lokale ose qendrore të ngarkuara për infrastrukturën përkatëse. Së këtejmi, për qëllimet e akvizicionit të tokës, çdoherë kur do të përmendet institucioni-shfrytëzues, ata do të jenë autoritetet lokale ose qendrore, përkatësisht nëse bëhet fjalë për eksproprijimin e tokës për rrugë lokale, atëherë institucion-shfrytëzues do të jetë Institucioni vetëqeverisja lokale dhe në këtë mënyrë pushteti lokal do ta kryejë akvizicionin e tokës. Nëse rruga klasifikohet si rrugë rajonale ose nacionale, atëherë Ministria e Transportit do të jetë institucioni-shfrytëzues dhe në këtë mënyrë Ministria e Transportit do ta vazhdojë procesin e akvizicionit të tokës.

Regjistrimi: Hulumtimi i ekonomive shtëpiake, i cili i përfshin të gjithë personat e prekur nga Projekti, pavarësisht të drejtës ose pronësisë. Ai siguron listë të plotë të të gjithë personave të prekur nga Projekti dhe pronën e tyre. Ai mund të përdoret për t'i minimizuar pohimet e gabuara nga ana e njerëzve të rajonit të përfshirë me Projektin, me shpresë se do të kompensohen dhe/ose zhvendosen.

Kompensimi: Pagesa me para të gatshme ose në natyrë me vlerën e zëvendësimit të pronës së marrë me detyrim: Veprime të cilat mund të ndërmerren pa pëlqimin e informuar ose fuqinë e zgjedhjes së personave të zhvendosur.

Zhvendosja e detyrueshme (ZHD): zhvendosja e pashmangshme e njerëzve dhe/ose ndikimi mbi jetën e tyre, asetet dhe pronën e përbashkët, të cilat burojnë nga projektet zhvillimore që krijojnë nevojë për rimëkëmbjen e jetës së tyre, burimet e të ardhurave dhe bazat e pronës.

Personi i Prekur nga Projekti (PPP) përfshinë cilindo qoftë person ose personat, në llogari të zbatimit të Programit, apo cilindo qoftë nga projektet e tij, nën-komponentët ose pjesët, do të ketë/kenë ndikim negativ mbi të drejtën e tyre, pronën ose interesin e çdo shtëpie, tokë (përfshirë tokën për banim, bujqësore dhe kullosa) ose mbi cilat do qoftë asete të

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

paluajtshme ose të luajtshme të cilat i ka fituar ose i posedon, plotësisht apo pjesërisht, përkohësisht ose përgjithmonë, ose ndikim negativ mbi veprimtarinë, profesionin, punën, vendin ku jeton ose vendbanimin ose mbi standardin e tyre jetësor.

**Përfshirja e publikut:** Dialog i cili përfshin konsultimin dhe komunikimin midis ithtarëve të Projektit dhe publikut. Kjo përfshin diseminacionin, përfaqësimin dhe prezantimin e informatave.

**Zhvendosja:** Nocioni i përgjithshëm në lidhje me akvizicionin e tokës dhe kompensimin për humbjen e ve, pavarësisht nëse bëhet fjalë për zhvendosje të vërtetë, humbje të tokës, strehimit, t ose t e tjera për jetë dhe i përfshinë të gjitha masat e ndërmarra për zbutjen e të cilësdo qoftë prej këtyre dhe të gjitha ndikimet negative të pronës së personave të prekur nga Projekti dhe/ose të ve të tyre për jetë, përfshirë edhe kompensimet, zhvendosjet (aty ku është përkatëse) dhe rehabilitimin;

**Plan Veprimi për Zhvendosje (PVZH):** Plan Veprim me afate kohore me buxhet, i cili e përcakton strategjinë e zhvendosjes, objektivat, opsionet, të drejtat, veprimet, miratimet, përgjegjësitë, monitorimin dhe evaluimin.

Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH) i referohet këtij dokumenti i cili është kornizë e përgjithshme e politikave për zhvendosje të personave të prekur me Projektin (PPP). Korniza e Politikave për Zhvendosje e përshkuan procesin dhe metodat e zhvendosjes sipas programit, përfshirë edhe kompensimet, zhvendosjen dhe rehabilitimin e personave të prekur nga Vlera e Programit për zhvendosje: Metoda e vlerësimit të ve, e cila ndihmon në përcaktimin e shumës së mjaftueshme për t'u kompensuar t e humbura dhe për t'u mbuluar shpenzimet e transaksionit. Gjatë aplikimit të kësaj metode të vlerësimit, amortizimi i objekteve dhe ve nuk duhet të merren parasysh;

**Zhvendosja:** Zhvendosja fizike e personave të prekur nga Projekti prej vendeve të tyre të jetesës para programit: Ata të cilët kanë interes sa i përket zhvillimit të Projektit dhe të cilët do të përfshihen në procesin e konsultimeve, e përfshin cilindo qoftë individ ose grup të prekur ose atë i cili beson se është i prekur nga Projekti; dhe cilindo qoftë individ ose grup i cili mund të ketë rol të rëndësishëm në formësimin e Projektit ose të ndikojë mbi Projektin, pozitivisht ose negativisht, duke e përfshirë bashkësinë/popullsinë - ekonomitë familjare.

**Grupet vulnerable:** Grupe të ndryshme të njerëzve të cilët mund të pësojnë nga efektet tejet të mëdha të zhvendosjes, siç janë personat e moshuar, të rinjtë, personat me handicap, të varfëritë, grupet e izoluar dhe prindërit e vetëm.

Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)



## 1. Hyrje

---

### 1.1 Të dhëna themelore për Projektin

Projekti për konkurrencë lokale dhe rajonale është një operacion investues, me afat katërvjeçar, i financuar me grant nga Bashkimi Evropian. Projekti për konkurrencë lokale dhe rajonale do të menaxhohet si fond hibrid dhe do të përbëhet nga tre komponentë, njërin do ta zbatojë Banka dhe dy të tjerët Qeveria e Maqedonisë. Aktivitetet e komponentit të cilin do ta zbatojë Banka (komponenti 1) do të ndihmojnë në drejtim të vazhdimit, mbindërtimit dhe zgjerimit të kapaciteteve dhe aktiviteteve për ndihmë teknike në fushën e turizmit në nivel qendror në kuadër të Programit për mbështetjen e industrive konkurrense dhe inovacioneve në Maqedoni (grant nga fondi i trustit me më shumë donatorë, i cili do të jetë efektin deri në muajin e gjashtë të vitit 2016). Njëkohësisht, në komponentin 1 do të financohet ndihma teknike dhe konsulente e Bankës në lidhje me politikat dhe masat në nivel sektorial që do të jenë në dobi dhe do t'i plotësojnë aktivitetet në kuadër të komponentëve të cilët do t'i zbatojë pranuesi (komponentët 2, 3 dhe 4). Komponenti 2 do ta financojë ndihmën teknike, pajisjen, si dhe ndërtimin e kapaciteteve në destinacione të përzgjedhura turistike, të cilat janë të afta të demonstrojnë potencial solid në treg, lokacion strategjik, si pjesë e një "teme" më të gjerë ose marsh rutë dhe ndikim më të madh mbi zhvillimin. Mbështetja e menaxhimit, shkathtësive, inovacioneve, si dhe të planifikimit lokal me investime kyç në infrastrukturën publike (Komponenti 3) konsiderohen si qasje më efikase në drejtim të zhvillimit të destinacioneve konkurrense dhe produktive, të cilat janë joshëse për investimet private dhe për konsumatorët. Komponenti 3 do të sigurojë investime në infrastrukturë dhe në shërbimet që kanë të bëjnë me turizmin e destinacioneve. Ky komponent do t'i mbështes investimet e mëdha dhe të vogla në destinacionet e përzgjedhura turistike, në mënyrë që të plotësohet oferta e produkteve, sa i përket atraksioneve, sajteve, si dhe përvojës së përgjithshme të vizitorëve. Nën-projektet e propozuara, gjithashtu mund të zbatohen në partneritet me organizatat qytetare dhe palët e interesuara të sektorit privat, përfshirë edhe organizatat profesionale.

Investimet në infrastrukturën e nën-projekteve mund të përfshijnë, si vijojnë:

- Restaurimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore, fasada të objekteve tradicionale dhe objekteve me rëndësi historike (objekte me vlerë historike dhe/ose me arkitekturë tradicionale);
- Sanimi i shërbimeve infrastrukturore të komunës dhe shërbimeve komunale në zonat qendrore historike (bërthama historike) dhe objekteve shtetërore për pushim;
- Përmirësimi i rrugëve për hyrje-dalje deri te lokacionet dhe atraksionet, rregullimi i hapësirave publike dhe vendeve publike për parkim
- Vendosja e sinjalistikës;
- Mbindërtimi i vendeve publike dhe objekteve kulturore, objekteve për ski dhe spa-qendra;
- Harta dhe mbindërtimi i shtigjeve për këmbësore dhe çiklizëm;
- Ndërtimi ose rehabilitimi i qoshqeve ose zyrave turistike informative, si dhe të toaleteve publike.

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

Shfrytëzuesit primar të projekteve infrastrukturore do të jenë bashkësitë lokale, komunat, si dhe vizitorët lokal, rajonal dhe ndërkombëtar. Shfrytëzues të tërthortë do të jenë organizatat profesionale dhe palët e interesuara nga sektori privat, të cilët do të kenë beneficione nga përmirësimi i kushteve të punës dhe zhvillimit të tregut. Në kuadër të nën-komponentit investime, Projekti do të sigurojë grante për mbështetjen e fuqizimit të vlerave të shërbimeve të ofruara turistike. Nën-komponenti do të sigurojë grante të vegjël për aktivitete që do të jenë në shërbim të këtyre shërbimeve, duke ndihmuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e problemeve kyç, të theksuara në Planet zhvillimore të destinacionit (Komponenti 2). Aktivitetet mund të përfshijnë ndihmë teknike (p.sh. disenjim dhe implementim të programeve lokale për ndërlidhje, module për trajnime lidhur me shkathësitë e bazuara mbi kompetencën) mbështetje teknike dhe financiare (p.sh. për gara që kanë të bëjnë me inovacionet turistike në shkolla ose shoqata), punë më të vogla (p.sh. korrigjime të infrastrukturës ose restaurim), pajise (p.sh. TIK) ose aktivitete promovuese (motivim për rekrutim, marketing të produkteve lokale, biznes - me - biznes integrimin, brendimi dhe aktivitete marketingu). Grantet do të zbatohen për persona duke i përfshirë edhe agjencitë publike, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, shoqatat e sektorit privat, trajnime/ofruar të shërbimeve arsimore dhe organizata joqeveritare (OJQ). Ky nën-komponent, gjithashtu, do të financojë inovacione që do t'i ndërmarrin ndërmarrjet private mikro dhe të vogla për zhvillimin e produkteve të reja ose për përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve në zinxhirin e vlerës së turizmit; për zbatimin e aktiviteteve të marketingut ose për zhvillimin e biznesit; për realizimin e trajnimeve; blerjen e pajisjes së imët; për realizimin e riparimeve të vogla në objektet ekzistuese dhe aktivitete të tjera, me përjashtim të objekteve të reja. Grante për ndërmarrjet private do të kërkojnë kontribut vetjak në lartësi prej 50-60 për qind të investimeve/ me para të gatshme.

Në rastet, në të cilat sektori privat do të jetë shfrytëzues i grantit, atëherë investimet nuk mund të zbatohen në asnjë pronë tjetër nga ajo që është në pronësi të pranuesit ose vendit publik, i cili nuk është në përdorim nga asnjë person tjetër fizik ose juridik. Shfrytëzuesi i grantit mund të investojë në hapësirë publike me pëlqimin e agjencisë përkatëse qeveritare pasi që të konstatohet se hapësira nuk shfrytëzohet nga ndonjë person tjetër.

### **1.2 Arsyetim për hartimin e Kornizës së Politikave për Zhvendosje**

Ky dokument është Kornizë e Politikave për Zhvendosje (KPZH) për Projektin e propozuar për konkurrencë lokale dhe rajonale. Ajo i përshkruan politikat, procedurat dhe proceset që do të pasojnë gjatë Projektit në zbutjen e ndikimeve negative sociale, si rezultat i aktiviteteve të Projektit ndaj personave të prekur nga Projekti, me ose pa akt-pronësie, toka/prona e të cilëve, biznesi dhe të tjera janë shpronësuar për kryerjen e punëve ndërtimore.

Korniza e Politikave për Zhvendosje u hartua për zbatimin e akvizicionit që do të paraprijë të tokës dhe të zhvendosjeve potenciale për ndërtimin e rrugës, në përputhje me kërkesat e Bankës Botërore, (BB) – Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNNZH) dhe politikave të saj operative 4.12, si dhe me legjislacionin nacional.

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

BB MO 4.12 sugjeron se Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH) duhet të jetë e përpiluar gjatë vlerësimit nëse madhësi dhe lokacioni i tokës ose zhvendosja nuk mund të dihen meqë Projekti ka disa komponentë.

Projekti për konkurrencë lokale dhe rajonale do ta financojë përmirësimin e infrastrukturës e cila mund të ndikojë mbi pronën private dhe mbi tokën publike që mund të jetë në përdorim nga ana e personave privatë ose të ketë ndikime të caktuara mbi bizneset e vegjël. Megjithatë, ky ndikim nuk mund të përcaktohet sepse vet projekti është një program me të cilin investimet do të caktohen gjatë zbatimit të Projektit. Së këtejmi, sasia e saktë dhe precize e tokës akoma nuk është konfirmuar dhe për rrjedhojë ajo është në përgatitje e sipër dhe jo sajt rap specifik.

### 1.3 **1.3 Ndikime të pritshme**

Sa i përket listës së investimeve të mundshme nuk do të ketë zhvendosje të njerëzve dhe as që do të ketë nevojë për akvizicion të tokës me përmasa të mëdha. Megjithatë, nëse ka ndikime, të njëjtat do të jenë fraksione lineare të tokës për eksproprijim ose dimensione të vogla, jo më të mëdha se disa qindra metra katrorë, në tokë e cila nuk do të jetë lineare. Grantet e mundshëm për infrastrukturë janë si vijojnë:

- Restaurimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore, fasada të objekteve tradicionale dhe objekteve me rëndësi historike (objekte me vlerë historike dhe/ose me arkitekturë tradicionale);
  - Sanimi i shërbimeve infrastrukturore të komunës dhe shërbimeve komunale në zonat qendrore historike (bërthama historike) dhe objekteve shtetërore për pushim;
  - Përmirësimi i rrugëve për hyrje-dalje deri te lokacionet dhe atraksionet, rregullimi i hapësirave publike dhe vendeve publike për parkim
  - Vendosja e sinjalistikës;
  - Mbindërtimi i vendeve publike dhe objekteve kulturore, objekteve për ski dhe spa-qendra;
  - Harta dhe mbindërtimi i shtigjeve për këmbësore dhe çiklizëm;
  - Ndërtimi ose rehabilitimi i qoshqeve ose zyrave turistike informative, si dhe të toaleteve publike.

Toka potenciale për eksproprijim mund të jetë tokë bujqësore ose ndërtimore, varësisht nga zonat e shfrytëzimit të tokës. Gjithashtu, mund të jetë i nevojshëm bllokimi i përkohshëm i hyrje-daljes deri te toka ose objekti ose zhvendosje e përkohshme e bizneseve të vegjël, siç janë qoshqet ose shitja nga tendat. Natyra e ndikimeve tanimë është vështirë të përcaktohet, por meqë ndikimet do të jenë me përmasa të vogla, fillimisht do të nevojitet të bëhet akvizicioni i tokës, pastaj Agjencia për zbatim do të përgatis version të shkurtër të Planit të Veprimit për zhvendosje. Tani e tutje, për projektet rrjedhëse, autoritetet përkatëse lokale ose organi kompetent i pushtetit qendror, me mbështetjen e Agjencisë për zbatim do të përpilojnë version të shkurtër të Plan Veprimit për zhvendosje, atëherë kur do të jetë e nevojshme.

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

### 1.4 Qëllimet dhe parimet e politikave për zhvendosje

Qëllimi i Kornizës së Politikave për Zhvendosje është ta drejtojë përgatitjen e kornizave të politikave për zhvendosje, të cilat do të sigurojnë se të gjithë personat e prekur do të konsultohen në mënyrë përkatëse, të gjitha mekanizmat e ankimit do t'i kenë të aksesshëm dhe në mënyrë përkatëse e në kohë do t'u paguhet shpenzimet e zhvendosjes ose vlera e tregut (sado që të jetë e lartë) për humbjen e tyre, ndërsa do të parashikohen edhe masa për sanim, kështu që ata do të kompensohen njëjloj si të mos ekzistonte Programi.

Parimi konsiston me atë se zhvendosja e detyrueshme duhet të shmanget aty ku është e mundur, ose e njëjta të minimizohet, me ç' rast do të hulumtohen të gjitha alternativat e qëndrueshme gjatë disenjimit të Projektit. Nëse është e pashmangshme, aktivitetet e zhvendosjes duhet të jenë të planifikuara dhe të realizuara si programe të qëndrueshme për zhvillim, sigurim të resurseve të mjaftueshme për investime, në mënyrë që t'u mundësohet personave të prekur nga Projekti që t'i shijojnë përfitimet nga i njëjti. Pastaj, personat e prekur duhet të konsultohen dhe të përfshihen në planifikimin dhe realizimin e kompensimit; si dhe t'u ndihmohet në angazhimet e tyre për përmirësimin e mirëqenies dhe standardit jetësor në kohë reale, ndërsa nëse preken t e tyre për jetë dhe standardi jetësor, deri në nivelin para Projektit ose më shumë.

### 1.5 Procedura e hartimit dhe miratimit të Plan Veprimit për Zhvendosje

#### 1.5.1 Plan Veprimi për Zhvendosje (PVZH):

Kjo Kornizë e Politikave për Zhvendosje e rregullon hartimin e versionit të shkurtër të Plan Veprimit për Zhvendosje. Plan Veprimi për Zhvendosje i këtij Projekti është në përputhje me këtë Kornizë të Politikave për Zhvendosje, si dhe do të zhvillohet dhe do t'i dërgohet për miratim Bankës Botërore.

Sipas MO 4.12, të gjitha projektet që përmbajnë akvizicion të tokës dhe/ose zhvendosje duhet të kenë Plan Veprim për Zhvendosje. Vëllimi dhe detajet e planit të zhvendosjes ndryshojnë sa i përket madhësisë dhe kompleksitetit të blerjes së tokës dhe/ose ndikimit nga zhvendosja, përkatësisht Plan Veprimi i plotë për zhvendosje kërkohet çdoherë kur blerja e tokës të Projektit ndikon mbi më shumë se 200 njerëz, përfshinë më shumë se 10 për qind të cilësdo qoftë pronë dhe përfshinë zhvendosje fizike të popullsisë. Plan Veprimi i shkurtër për Zhvendosje është i pranueshëm nëse zhvendosen më pak se 200 njerëz. Madje edhe nëse janë prekur më shumë se 200, e gjithë blerja e tokës nuk është e madhe (shtrirja në 10 për qind ose më pak nga të gjitha pronat) dhe nuk përfshihet zhvendosja fizike, i pranueshëm është Plan Veprimi i shkurtër për Zhvendosje. Ky Projekt nuk përfshinë zhvendosjen e personave të përfshirë me Projektin e as nuk përfshinë ekspropriim të sipërfaqeve më të mëdha të tokës.

Korniza e shkurtër e Politikës për Zhvendosje i përmban elementet si vijojnë:

- regjistrim anketues të personave të përfshirë me Projektin dhe vlerësimin e ve;
- përshkrim të kompensimit dhe ndihmë tjetër për zhvendosje e cila duhet të sigurohet;
- konsultime me personat e prekur nga Projekti për alternativa të pranueshme;
- përgjegjësi institucionale për zbatimin dhe procedurat për procedim ankimor;

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

- procedurat për monitorim dhe zbatim; dhe
- kornizë kohore dhe buxhet.

Në rast se disa nga personat e prekur me Projektin mund të humbasin më shumë se 10 për qind prej ve të tyre produktive ose të kërkojnë zhvendosje fizike dhe pastaj plan, gjithashtu, e përfshin hulumtimin socio- ekonomik që të përcaktohet ndikimi dhe nëse është e nevojshme edhe masa përkatëse për restaurimin e të ardhurave.

Fillimisht, draft-versioni do t'i dërgohet Bankës Botërore në mënyrë që të shmangen vërejtjet para publikimit, ndërsa versioni i final i Plan Veprimit për Zhvendosje do t'i dërgohet BB nga ana e Agjencisë për Zbatim në emër të institucionit-shfrytëzues (organet përkatëse kompetente lokale ose Agjencia e pushtetit qendror e cila e ka fituar grantin investues, siç është përshkruar më lartë), me qëllim që të shmangen vërejtjet, ndërkaq pastaj do të fillojë implementimi. Implementimi i Plan Veprimit për Zhvendosje do të përfundojë para fillimit të punëve. Atëherë, kur nuk do të ketë kurrfarë vërejtjesh, do të fillojnë aktivitetet për kompensim, zhvendosje dhe rehabilitim, të cilat do të përfundojnë para ndarjes së marrëveshjeve për punët ndërtimore.

### 1.5.2 Skringing procesi për zhvendosje (eksproprijimi i tokës)

Hapat në vijim e përshkruajnë procesin e zhvendosjes të Projektit

1. Përfundimi i disenjit final të Projektit duhet të financohet
2. Pas përfundimit të disenjit final, ESP ose institucioni-shfrytëzues do të angazhojnë kompani të jashtme për zbatimin e raportit për eksproprijim e që njëkohësisht do të jetë datë e kthesës
3. ESP dhe Agjencia-shfrytëzuese do ta informojnë publikun e gjerë për periudhën e zbatimit të sondazhit gjeodezik (matjen) për raportin e eksproprijimit
4. Pas paraqitjes së raportit të përfunduar për eksproprijim, i cili do t'i dërgohet njësisë për zbatimin e Projektit ose institucionit-shfrytëzues, njësia për zbatimin e Projektit me resurset e veta ose përmes firmës së jashtme do të hartojë draft-Plan Veprim për Zhvendosje dhe do ta përcaktojë vëllimin e ndikimit mbi personat e prekur nga Projekti.
5. Draft-Plan Veprimi për Zhvendosje hartohet dhe i dërgohet Bankës Botërore për shqyrtim
6. Banka Botërore do ta shqyrtojë, do ta spastrojë nga vërejtjet dhe do ta kthejë draft-Plan Veprimin për Zhvendosje
7. Njësia për zbatimin e Projektit do ta publikojë draft-Plan Veprimin për Zhvendosje dhe do të organizojë konsultime me personat e prekur nga Projekti, në mënyrë që të përcaktohet numri i personave të prekur, mënyra e kompensimit dhe masat e propozuara për zbutje dhe kompensim.
8. Konkluzionet do të inkorporohen në Propozim-Plan Veprimin për Zhvendosje
9. Versioni final i Plan Veprimit për Zhvendosje do t'i dërgohet Bankës Botërore që t'i evitojë të gjitha vërejtjet
10. Shpallja e versionit final të Plan Veprimit për Zhvendosje
11. Zbatimi i Plan Veprimit për Zhvendosje/ Përfundimi i procesit të eksproprijimit

## 2 Korniza institucionale dhe juridike

---

### 2.1 Korniza institucionale

Institucionet në vijim, të cilat kanë role dhe përgjegjësi të ndryshme, janë aktorët kryesor në procesin e eksproprijimit:

**Avokatura e Shtetit e Republikës së Maqedonisë** është institucion qeveritar i cili ndërmerr masa dhe ligjore për mbrojtje juridike të të drejtave pronësore dhe interesave të Republikës së Maqedonisë, si dhe ushtron edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.

**Ministria e Transportit dhe Lidhjeve** është institucion qeveritar përgjegjës për lëshimin e lejeve për ndërtim dhe për monitorimin e procesit të eksproprijimit në lidhje me përfundimin e procesit të eksproprijimit.

**Agjencia e Kadastrës dhe Patundshmërive në Republikën e Maqedonisë** i udhëheq dhe regjistron informatat për të drejtat e pronësisë mbi tokën në Republikën e Maqedonisë. Ajo gjatë procesit mund të konsultohet me qëllim që të sigurohen informata të vlefshme dhe valide për pronësinë dhe shfrytëzimin rrjedhës /dhënien me qira të tokës.

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave** e bën transformimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Institucionet në vijim ofrojnë një spektër të gjerë të ndihmës e cila do të mundësojë mbështetje dhe do ta lehtësojë procesin e konsultimeve për implementimin e Plan Veprimit për Zhvendosje.

#### **Niveli nacional:**

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave** gjatë procesit mund të konsultohet në drejtim të krijimit të pakove për kompensim. Gjithashtu, mund të konsultohet edhe gjatë procesit të vlerësimit të kompensimit për sipërfaqet e humbura me të mbjella.

**Avokati i Popullit** mund të konsultohet për këshilla të ndryshme juridike në lidhje me kontestet gjyqësore midis personave të prekur me Projektin dhe organeve qeveritare.

**Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale dhe qendrat për punë sociale** të themeluara nga Qeveria mund të konsultohen gjatë procesit të realizimit të Plan Veprimit për Zhvendosje. Qendra mund të ofrojë kontribut të konsiderueshëm, sa i përket identifikimit, komunikimit dhe adresimit të grupeve vulnerable sociale, dhe në këtë mënyrë duke dhënë drejtime përkatëse për përcaktimin e ve të kompensimit / pako për grupet e këtilla.

#### **Niveli lokal:**

Niveli i bashkësisë lokale (fshati): Përfaqësuesit zyrtarë të fshatrave lokal duhet të konsultohen dhe të përfshihen në mënyrë aktive në përpilimin dhe zbatimin e proceseve për zhvendosje të cilat janë

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

nën juridiksionin e tyre. Ato mund të konsultohen dhe të përfshihen si ndërmjetësues në procesin e vendosjes sipas kundërshtimeve/pakënaqësisë para se të njëjtat t'u dërgohen komisioneve të cilët vendosin për ankesat dhe parashtresat.

t për zhvendosje (eksproprijim) do të sigurohen nga institucionet-shfrytëzues, në shumicën e rasteve ky do të jetë pushteti lokal.

### 2.2 Ndhimja juridike

Në Republikën e Maqedonisë, aktet ligjore të cilat u janë prezantuar në vijim i rregullojnë çështjet e fitimit të të drejtave të pronësisë shtetërore mbi parcela private për shkak të nevojave publike të domosdoshme për aktivitete ndërtimore për ndërtim të rrugës:

- Ligji për eksproprijim ("Gazeta Zyrtare e Republikë së Maqedonisë", numër 95/12, 131/12, 24/13, 27/14);
- Ligji për rrugë publike ("Gazeta Zyrtare e Republikë së Maqedonisë", numër 84/08; 52/09; 114/09; 124/10; 23/11; 53/11; 44/12; 168/12; 163/13; 187/13; 39/14; 42/14; 166/14 dhe 44/15);
- Ligji për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikë së Maqedonisë", numër 130/09, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/13, 137/13, 163/13, 27/14, 28 / 14, 42/14, 115/14, 149/14, 187/14 dhe 44/15).
- Ligji për Vlerësim ("Gazeta Zyrtare e Republikë së Maqedonisë", numër 115/10, 158/11, 185/11, 64/12, 188/14)
- Metodologjia për vlerësimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme ("Gazeta Zyrtare e Republikë së Maqedonisë", numër 54/12)
- Rregullore për mënyrën e klasifikimit kadastral dhe për vendimmarrjen dhe shënimin e ndryshimit të kulturës kadastrale dhe klasës së tokës ("Gazeta Zyrtare e Republikë së Maqedonisë", numër 144/13)
- Ligji për trajtimin e objekteve të ndërtuara pa leje ("Gazeta Zyrtare e Republikë së Maqedonisë", numër 23/11, 54/11, 155/12, 53/13, 72/13, 44/14 dhe 115/14)
- Ligji për pronësi dhe të drejta tjera pronësore ("Gazeta Zyrtare e Republikë së Maqedonisë", numër 18/01, 99/08, 139/09 dhe 35/10);
- Ligji për trajtimin e parashtresave dhe propozimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikë së Maqedonisë", numër 82/2008, 13/13);

Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

- Rregullore për mënyrën e trajtimit të parashtresave dhe propozimeve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, numër 2/09);
- Ligji për kadastrën e patundshmërive (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, numër 40/08, 158/10, 51/11);

### 2.2.1 Procesi i eksproprijimit

Legjislacioni maqedonas e trajton zhvendosjen e detyrueshme dhe rindërtimin e jetës në kuadër të kornizës së vet ligjore për eksproprijim, me idenë themelore se pronarëve të pronës duhet t’u paguhen humbjet e tyre, më së shpeshti në kontekstin monetar.

Ligji për eksproprijim (versioni i plotësuar i bashkëngjitur si Aneksi 5) (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 95/12, 131/12, 24/13, 27/14) e rregullon procedurën e eksproprijimit të pronës për projekte me interes publik dhe të drejtave të përafërta për pronë të patundshme (patundshmëri). Ndërtimi i linjës infrastrukturore, në këtë rast rrugë ekspres, bën pjesë në kuadër të Projektit me interes nacional/publik. Arsyetimi juridik për atë se pse duhet të besohet se Projekti është me interes publik i bashkëngjitet kërkesës për eksproprijim (si pjesë e procesit të njëjtë) dhe i dërgohet Avokatit të Shtetit, nga ana e shfrytëzuesit të eksproprijimit. Avokatura e Shtetit e Republikës së Maqedonisë, nga ana tjetër, i përfaqëson institucionet publike, fondet, agjencitë, drejtoritë, institucionet publike, shoqëritë tregtare dhe institucionet e tjera të themeluara nga Qeveria. Për këtë Projekt, Qeveria e Republikës së Maqedonisë e aprovoi iniciativën për eksproprijim, ndërsa Avokatura e Shtetit e zbaton.

Organi kompetent për eksproprijim, sipas propozimit për eksproprijim, cakton seancë në të cilën thirret pronari i pronës, përkatësisht bartësit e të drejtave të tjera pronësore të pronës e cila është objekt i eksproprijimit, si dhe propozuesi i eksproprijimit. Në seancë përcaktohet ekzistimi i interesit publik, pastaj e drejta e pronësisë dhe të drejta tjera reale, si dhe lloji dhe lartësia e kompensimit, si dhe fakte dhe rrethana të tjera relevante për procesin e eksproprijimit.

Organi kompetent, pas paraqitjes së propozimit për eksproprijim deri te pronari i pronës, përkatësisht bartësit e të drejtave të tjera pronësore mbi pronën, duhet medoemos të caktojë dhe të mbaj seancë për propozimin edhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së propozimit deri te pronari i pronës ose bartësit e të drejtave tjera pronësore mbi pronën.

Seanca mund të përfundojë me marrëveshje për kompensim (pagesë me para ose sigurim të pronës tjetër përkatëse), si dhe ta caktojë lartësinë e kompensimit dhe nëse kjo është e përcaktuar në para, edhe afatet e pagesës. Kjo marrëveshje është dokument ekzekutiv dhe pas nënshkrimit të marrëveshjes konsiderohet se procesi i eksproprijimit dhe procedura e përcaktimit të kompensimit ka përfunduar dhe është finale.

Nëse nuk arrihet marrëveshje, organi i eksproprijimit, duke u mbështetur në faktet e përcaktuara në procedurë do të lëshojë aktvendim për eksproprijim. Kundër aktvendimit për



## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

eksproprijim mund të paraqitet padi deri te Gjykata Administrative në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, jep me qira tokë bujqësore shtetërore. Kjo Ministri e prish marrëveshjen ekzistuese me qiramarrësin dhe nënshkruan marrëveshje të re me kushte të njëjta, sikurse edhe ato paraprake, por pa shumën e tokës që do të merret. NPRRSH do t'i kompensojë këta qiramarrës përmes shfrytëzimit të metodologjisë së njëjtë si kompensim për pronarët e tokës por pa kompensim të tokës.

Aspekte tjera kryesore të Ligjit për eksproprijim janë prezantuar në vijim:

Kompensimi – Neni 18 “Për eksproprijimin e patundshmërisë paguhet kompensim i drejtë që nuk mund të jetë më i ulët se vlera e tregut të patundshmërisë. Vlera e tregut të patundshmërisë përcaktohet me kushte dhe mënyrë të përcaktuara me këtë ligj, sipas metodologjisë, rregullave dhe standardeve në pajtim me Ligjin për vlerësim. E drejta që të kërkohet kompensim për patundshmërinë e eksproprijuar nuk parashkruhet”. Neni 37 thekson se vlera e tregut e patundshmërisë së eksproprijuar dhe prona e cila jepet si kompensim, përcaktohet nga ana e vlerësuesit të autorizuar, në përputhje me Ligjin për vlerësim. Kompensimi për pronën e eksproprijuar zakonisht përcaktohet me financiare, përveç nëse pronari i mëparshëm ose bartësit e të drejtave të tjera pronësore dhe propozuesi i eksproprijimit nuk merren vesh ndryshme.

Pronari i patundshmërisë së eksproprijuar, gjithashtu, ka të drejtën e kompensimit të bimëve, farërave, tokës pyjore dhe frutave, nëse të njëjtat nuk janë përfshirë në vlerën e tregut të tokës. Pronari i pronës nuk do ta gëzojë të drejtën e kompensimit ndaj investimeve të realizuara nga dita e paraqitjes së propozimit për eksproprijim.

Nëse në pronën e cila eksproprijohet zhvillohet një aktivitet i caktuar ekonomik, efekti nga ndërprerja e këtij aktiviteti duhet të merret parasysh gjatë përcaktimit të kompensimit për eksproprijim. Kjo shumë përcaktohet nga eksperti, në përputhje me Ligjin për vlerësim.

Propozimi për eksproprijim, për çdo pronë individuale, përmban informata për:

- Propozuesin e eksproprijimit;
- Atë për të cilin propozohet eksproprijimi;
- Pronarin e pronës (emri personal ose emërtimi, vendqëndrimi, selia);
- Bartësin e të drejtave të tjera reale (emri personal ose emërtimi, vendqëndrimi, selia);
- Tipin e objektit ose për realizimin e punëve për të cilat propozohet eksproprijimi.

Propozimi për eksproprijim shoqërohet me dokumentacionin si vijon:

- Ekstrakt nga Ligji për planifikim hapësinor ose nga projekti i miratuar për infrastrukturë;
- Raport gjeodezik me të dhëna numerike për pronën për të cilën propozohet eksproprijimi;
- Ofertë për kompensim ekuivalent me vlerën e tregut të patundshmërisë, të përcaktuar nga vlerësuesi i autorizuar në përputhje me Ligjin për vlerësim;
- Listë e pronës e cila propozohet për eksproprijim;

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

- Dëshmi për ekzistimin e ve për kompensim.

Si plotësim i Ligjit për eksproprijim, dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit për patundshmëri dhe për të drejta të tjera pronësore janë po ashtu relevante për blerjen e tokës dhe zhvendosje:

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e garanton mbrojtjen juridike të pronësisë dhe thekson se asnjë person nuk mund të privohet nga prona e tij/e saj ose nga të drejtat të cilat burojnë nga e njëjta, përveç kur bëhet fjalë për interes publik të përcaktuar me ligj. Nëse prona është e eksproprijuar ose e kufizuar, garantohet kompensimi i drejtë, i cili nuk guxon të jetë më i ulët nga vlera e tregut.

- Në përputhje me Ligjin për patundshmëri dhe të drejta të tjera reale mbi pronësinë, asnjë person nuk mund të privohet nga prona e tij/e saj ose nga të drejtat të cilat burojnë nga i njëjti, përveç kur bëhet fjalë për interes publik të përcaktuar me ligj dhe me aktet e planifikimit hapësinor. Në raste të eksproprijimit (eksproprijim i plotë) ose kufizimit (eksproprijim jo i plotë), garantohet kompensim i drejtë të pronës i cili nuk do të jetë më i ulët nga vlera e tregut në momentin e eksproprijimit.

### **2.3 Parimet dhe procedurat për zhvendosje të Bankës Botërore të aprovuara me këtë Plan Veprim për Zhvendosje**

Kërkesat e Bankës Botërore në lidhje me zhvendosjen e detyrueshme janë përfshirë me MO 4.12 Zhvendosje e Detyrueshme. Këto politika mundësojnë garanci për zgjidhjen dhe zbutjen e rreziqeve nga varfëria: njerëzit ballafaqohen me varfërinë atëherë kur t e tyre produktive ose burimet e të ardhurave i humbin; njerëzit janë zhvendosur në mjedise në të cilat shkathtësitë e tyre produktive më pak mund të aplikohen dhe ku ekziston konkurrencë më e madhe të resurseve; aty ku institucionet e bashkësisë dhe rrjetet sociale janë të dobësuar; grupet farefisnore janë disperzuar; ndërsa identiteti kulturor, organet kompetente tradicionale dhe potenciali për ndihmë të ndërsjellë janë reduktuar ose janë zhdukur.

Objektivat kryesor të MO 4.12 janë si vijojnë:

- Zhvendosja e detyrueshme duhet të shmanget në ato vende ku është e mundshme, ose e njëjta duhet të minimizohet, me ç'rast do të analizohen të gjitha alternativat e qëndrueshme gjatë disenjimit të Projektit.
- Nëse zhvendosja është e pashmangshme, aktivitetet e zhvendosjes duhet të jenë të planifikuara dhe të realizuara si programe të qëndrueshme për zhvillim, përmes sigurimit të resurseve të mjaftueshme për investime në mënyrë që t'u mundësohet personave të prekur nga Projekti t'i gëzojnë përfitimet nga i njëjti. Personat e zhvendosur duhet të konsultohen dhe të kenë mundësi të marrin pjesë në planifikimin dhe zbatimin e programeve për popullimin e sërishëm;
- Personave të zhvendosur duhet t'u ndihmohet në angazhimet e tyre për përmirësimin e mirëqenies së tyre dhe standardit të jetës ose së paku t'i kthejnë në kushte reale, në nivelin e para zhvendosjes ose në nivelet të cilët e pranishme para fillimit të realizimit të Projektit, madje edhe në nivel më të lartë.

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

Në mënyrë që të arrihen objektivat e këtyre politikave, vëmendje e veçantë i përkushtohet nevojës së grupeve vulnerable në mesin e personave të zhvendosur, veçanërisht atyre personave të cilët janë nën pragun e varfërisë, të pastrehët, personat e moshuar, gra dhe fëmijë, popujt autokton, minoritetet etnike ose persona të zhvendosur të tjerë, të cilët nuk mund të mbrohen me legjislacionin nacional për kompensimin e tokës.

### 2.4 Analiza e boshllëqeve – legjislacioni maqedonas për eksproprijim dhe politikat mbrojtëse të Bankës Botërore

Dallimet kryesore midis kornizës juridike nacionale për eksproprijim në Republikën e Maqedonisë dhe politikave mbrojtëse të Bankës Botërore janë prezantuar në vijim. Analiza e boshllëqeve është prezantuar në tabelën 2.

Tabela 2: Dallime midis ligjeve/rregulloreve maqedonase dhe politikave të Bankës Botërore

Legjislacioni maqedonas	Politikat e Bankës Botërore për Zhvendosje të Detyrueshme	Konkluzion për boshllëqet	Veprime për zgjidhjen e mangësive
<b>Përshtatshmëria</b>			
Ligji maqedonas nuk njeh persona të cilët nuk kanë fletë pronësi formale për pronë	<p>a) Ata të cilët kanë të drejta formale ligjore mbi tokën (duke i përfshirë të drejtat zakonore dhe tradicionale të njohura me ligjet e vendit);</p> <p>b) ata të cilët nuk kanë të drejta formale ligjore mbi tokën në kohën e regjistrimit, por pohojnë se kanë të drejtë mbi tokën ose t me kusht që këto pohime të jenë të njohura në përputhje me ligjet e shtetit, përkatësisht të njihen përmes</p>	Marrë në përgjithësi, dispozitat e kornizës ligjore në Republikën e Maqedonisë dhe MO 4.12 të Bankës Botërore janë të njëjta, përveç dispozitat për personat të cilët nuk kanë të drejtë formale mbi pronën.	<p>Rekomandohet të ndiqet MO 4.12 i Bankës Botërore edhe pse nuk pritët të ketë persona të prekur nga Projekti nga kategoria (c).</p> <p>Iniciativa qeveritare për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje filloi në vitin 2010 dhe do të përfundojë në qershor të vitit 2014. Iniciativa për legalizimin e tokës së uzurpuar në mënyrë të paligjshme (oborr) filloi në vitin 2011, ndërsa filloi në tetor të</p>

Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

Legjislacioni maqedonas	Politikat e Bankës Botërore për Zhvendosje të Detyrueshme	Konkluzion për boshllëqet	Veprime për zgjidhjen e mangësive
	<p>procesit të identifikuar në planin për zhvendosje</p> <p>c) ata, të cilëve nuk u njihet e drejta ligjore apo e drejta mbi pronën të cilën e kanë uzurpuar.</p>		<p>vitit 2014.</p>
<b>Të drejtat</b>			
<p>Ligjet maqedonase nuk e përfshijnë vlerësimin socio-ekonomik në mënyrë që të përcaktohet vëllimi i vërtetë i ndikimit nga Projekti mbi palët e prekura</p>	<p>Zbatimi i regjistrimit dhe vlerësimi socio-ekonomik në kuadër të një fushe të prekur që të identifikohen personat që do të zhvendosen dhe të përcaktohet cili do të jetë kompensimi i pranueshëm dhe ndihma e pranueshme.</p>	<p>Dallimi midis praktikë së MO 4.12 dhe legjislacionit nacional konsiston me atë se MO 4.12 për dallim nga regjistrimi i humbjeve, vlerësimi socio-ekonomik kryhet që të përcaktohet nëse dhe si humbjet ndikojnë mbi jetën e personit të prekur nga Projekti.</p>	<p>Ligji nuk e ndalon marrjen e më shumë informacioneve nga të gjithë personat e prekur të atyre me ose pa fletë-pronësi. Në këtë mënyrë, jo vetëm që do të shqyrtohen t e humbura por edhe funksionet e tjera të cilat do të ndihmojnë në profilimin e personave të prekur. Duhet të jetë në përputhje me MO 4.12 të Bankës Botërore.</p>
<p>Kompensimi, konform Ligjit për eksproprijim është përcaktuar në përputhje me çmimin aktual të tregut pasi të merret parasysh vlera e tokës, shpenzimet e objekteve</p>	<p>Nivelet e kompensimit duhet të jenë të mjaftueshëm që ta zëvendësojnë tokën e humbur dhe t e tjera me çmim të plotë për zëvendësim në tregjet</p>	<p>Dallimi midis praktikës së MO 4.12 dhe legjislacionit nacional konsiston në atë se MO 4.12 personave të prekur me Projektin u siguron për përmirësimin e cilësisë së jetës ose për kthimin</p>	<p>Kompensimi do të bëhet sipas vlerës së plotë të zëvendësimit dhe në përputhje të plotë me MO 4.12</p>

Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

Legjislacioni maqedonas	Politikat e Bankës Botërore për Zhvendosje të Detyrueshme	Konkluzion për boshllëqet	Veprime për zgjidhjen e mangësive
(shpenzime banimi dhe afariste) dhe instalimeve, kulturave, tokës pyjore dhe dru për ndërtimtari, po ashtu e përfshin edhe kompensimin e shpenzimeve të transaksionit.	lokale.	në gjendjen e mëparshme.	
<b>Koha e kompensimit të pagesës</b>			
Në përputhje me paragrafin 48 të Ligjit, kompensimi duhet të paguhet/dorëzohet në afat prej 30 ditësh nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes për kompensim ose nga dita kur vendimi gjyqësor për kompensim është bërë i plotfuqishëm.	Marrja e tokës dhe ve të ngjashme mund të zhvillohet vetëm pas pagimit të kompensimit, ndërsa aty ku është e aplikueshme edhe atëherë kur do të sigurohen lokacione për zhvendosje si dhe kur do të sigurohen kompensime për shpërnguljen e personave të zhvendosur.	Ekziston boshllëk prej 15 ditësh, me ç'rast toka mund të merret para se të paguhet.	në lartësi të shumës së ofruar duhet të depozitohen në formë të garancisë, e cila ka të bëjë me depozitën e pranueshme për Bankën në rastin kur personi i prekur nuk e pranon kompensimin e propozuar dhe nëse kompensimi është ekuivalent me më së paku vlerën e zhvendosjes.  Kompensimin për tokën dhe t duhet të paguhet plotësisht, para marrjes së tokës.
<b>Informata dhe konsultime</b>			
Ata, të cilët kanë të drejta formale dhe ligjore janë	Informata në lidhje me kuantifikimin dhe çmimin e tokës,	Në ligjet maqedonase nuk ekziston detyrim ligjor	Planet për konsultime me personat e prekur nga Projekti,

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

Legjislacioni maqedonas	Politikat e Bankës Botërore për Zhvendosje të Detyrueshme	Konkluzion për boshllëqet	Veprime për zgjidhjen e mangësive
<p>informuar gjatë procesit të eksproprijimit (përkatësisht janë informuar se është paraqitur kërkesë për eksproprijim), para se të miratohet vendimi për eksproprijim zyra komunale, kompetente për eksproprijim duhet t'i thërras personat e prekur me të drejta formale ligjore në një takim, me qëllim që t'i prezantojë të gjitha faktet të cilat mund të jenë relevante për eksproprijimin.</p>	<p>objekteve dhe ve të tjera, të drejtat dhe shumat e kompensimit, si dhe ndihma financiare duhet plotësisht t'u prezantohet personave të prekur.</p> <p>Personave të zhvendosur dhe bashkësive të tyre u sigurohen informata relevante dhe në kohë, ata konsultohen për opsionet e zhvendosjes dhe ofrojnë mundësi për pjesëmarrje në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e zhvendosjes.</p>	<p>që të zbatohet diseminacion i hershëm të informatave dhe konsultime me personat e prekur nga Projekti para procesit të eksproprijimit. Personat e prekur nga Projekti nuk janë konsultuar ose nuk u është ofruar mundësi të marrin pjesë në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e zhvendosjes.</p>	<p>duke i përfshirë edhe bashkësitë vendore duhet të inkorporohen në Plan Veprimin për zhvendosje. Gjithashtu, draft-Plan Veprimi për Zhvendosje duhet të jetë objekt i debatit publik.</p>

### 3 Përshtatshmëria dhe autorizimi

#### 3.1 Persona të kualifikuar të prekur me Projektin

Parimin kryesor të cilin e ndjek kjo Kornizë e Politikave për Zhvendosje konsiston me atë se personave të prekur nga Projekti duhet t'u ndihmohet në angazhimet e tyre për përmirësimin e standardit të jetës së tyre të mëparshme, kapacitetin për realizimin e të ardhurave dhe nivelin e prodhimit ose së paku të njëjtat t'i kthejë në nivelin para Programit, me ç'rast mungesa e fletë-pronësisë nuk i përjashton individët nga beneficioni që të pranojnë kompensim dhe/ose ndihmë gjatë rehabilitimit. Në rast se ndikimi mbi personat e prekur nga Projekti është në formë të humbjes së ve dhe

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

vetëm në këto raste t e humbura duhet të kompensohen me çmimin e tregut apo sipas vlerës të zëvendësimit madje qoftë edhe më e lartë.

Personat e prekur nga Projekti, të cilët janë kualifikuar për të drejtën e kompensimit do t'i përfshijë edhe ata të cilët kanë të drejta formale ligjore mbi tokën ose mbi të tjera, si dhe ata të cilët fillimisht nuk kanë të drejta formale ligjore mbi tokën ose mbi t e tjera, megjithatë kanë kërkesë për të drejta në bazë të ligjeve të shtetit; me posedimin e dokumenteve, siç janë vërtetime për tatimin e paguar të tokës dhe vërtetime për qëndrim; ose në bazë të lejes nga autoritetet lokale për të qëndruar ose për ta shfrytëzuar tokën e përfshirë me Projektin.

Ata të cilëve nuk u njihet e drejta ligjore apo e drejta mbi tokën në të cilën gjenden, po ashtu anë të drejtë kompensimi për t e patundshme. Nuk parashikohet se do të ketë persona të këtillë të prekur me këtë Projekt.

Sendet e prekura mund të përfshijnë, por nuk kufizohen, si vijon:

- Tokë të përkohshme ose të përhershme e cila është e prekur;
- Struktura jorezidente, kultura, pemë ose të tjera të përkohshme ose të përhershme;
- Biznese të vegjël, siç janë kioskat ose pikat e shitjes;
- Humbje të të ardhurave të shkaktuara si rezultat i Projektit.

MO 4.12 i Bankës Botërore detekton se individët ose ekonomitë familjare ose cilido qoftë biznes që janë në zonat e përfshira me Projektin nuk janë të përshtatshëm për kompensim të dëmit pas ditës së kthesës. Të gjithë njerëzit, të cilët lëvizin në zonën e Projektit dhe/ose njerëz të cilët kryejnë punë ndërtimore, mbjellin pemë ose ndonjë aktivitet tjetër, pas ditës së kthesës nuk pranohen si persona të prekur me Projektin dhe në këtë mënyrë nuk do të marrin kompensim. Paraprakisht, këta persona do të njoftohen dhe prej të njëjtëve do të kërkohej t'i zbrazin hapësirat dhe t'i demontojnë objektet e prekura para se të fillojë zbatimi i Projektit.

### 3.2 Të drejtat

Blerja e tokës dhe zhvendosja do të zbatohet në përputhje me kornizën për kompensim dhe autorizime konform ligjeve dhe akteve normative maqedonase dhe MO 4.12 të Bankës Botërore. Aty ku këto kanë dallime, do të zbatohen të drejtat të cilat janë më të përshtatshme për personat e prekur nga Projekti, ashtu siç është përcaktuar në matricën në vijim. Gjatë kohës së identifikimit të kompensimit, gjatë përgatitjes së nën-Projektit, matrica për të drejtën dhe përshkrimin e të drejtës së kompensimit revidohet dhe azhurnohet në mënyrë përkatëse.

Matrica për të drejtën e prezantuar në Aneksin 1, mbështetet në premisën se ekspropriimi/zhvendosja e tokës, programet për rehabilitim dhe kompensim duhet të përmirësohen ose, së paku ta ruajnë standardin jetësor të personave të prekur nga Projekti në nivelin para fillimit të

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

Projektit dhe të sigurohet pjesëmarrje e tyre në përfitimet nga Projekti. Kjo pasqyrohet në parimet për kompensim, si vijojnë:

### **Përshtatshmëria**

Të gjithë personat e prekur nga Projekti, të cilët para datës së kthesës jetojnë në zonën e Projektit, do të kompensohen për humbjet e tyre dhe/ose do t'u ofrohet ndihmë gjatë rehabilitimit;

### **Kompensimi**

Personat e prekur nga Projekti do të kompensohen me zëvendësim të plotë dhe kompensim të shpenzimeve pa amortizim, dhe do të zhvendosen në rastin kur nuk do të ketë ndikim të këtillë, ose përsëri do të zhvendosen gjatë dhe pas përfundimit të konsultimit me të njëjtët. Shkallët pleniminare të kompensimit dhe shpenzimeve për zëvendësim do t'u propozohen personave të prekur nga Projekti, në mënyrë që të kenë mundësi për të bërë krahasim me shkallët aktuale të tregut;

Të gjitha taksat dhe tatimet për bartjen e pronës do të anulohen ose taksat dhe tatimet do të përfshihen në pakon e kompensimit të tokës dhe/ose shtëpisë. Organet kompetente shtetërore do t'u japin trajtim preferencial personave të prekur nga Projekti që t'i marrin fletë-pronësitë e nevojshme dhe vërtetimet zyrtare të pronës; Kjo në rastin e zhvendosjes nga shtëpitë.

### **Kompensimi në para**

Pagesa e kompensimit në para për t e humbura mund të jetë e përshtatshme kur (a) t e jetesës gjenden në tokën, por toka e marrë me Projektin është një pjesë e vogël e ve të prekura, ndërsa pjesa tjetër është ekonomikisht e qëndrueshme; (b) ekzistojnë tregje aktive për tokë, për strehim dhe punë, personat e prekur me Projektin i përdorin tregjet e këtilla dhe ekziston sasi e mjaftueshme e tokës dhe strehimit; ose (c) t e jetesës nuk bazohen në tokë. Nivelet e kompensimit në para duhet të jenë të mjaftueshme që ta kompensojnë tokën e humbur, si dhe t e tjera me çmimin e plotë për zëvendësimin në tregjet lokale, të përlllogaritura në ditën e kthesës.

Kompensim në para për tokë, për të gjitha strukturat e banimit, komerciale ose struktura të tjera do të paguhen me çmimin për zëvendësimin e këtyre strukturave, pa amortizimin e vlerës së strukturës duke i llogaritur të gjitha materialet e riparueshme ose në nivel të tregut cilido qoftë më i lartë nëse ekziston një treg i këtillë.

### **Konsultime dhe planifikime**

Planet e zhvendosjes do të zhvillohen dhe implementohen në konsultim me personat e prekur me Projektin.

Disenjë efektiv dhe në kohë, planifikim dhe implementim të zhvendosjes dhe masave për rehabilitim do të zbatohen në mënyrë që të shmangët prolongimi i panevojshëm dhe situatat e gjata e të pakëndshme për personat e prekur me Projektin.

### **Zhvendosja**



## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

Personat e prekur me Projektin do të kenë ndihmë të plotë për transportin e sendeve për përdorim personal, elektro-shtëpiakeve dhe materialeve të riparueshme dhe do të marrin kompensim për shpërngulje në emër të kompensimit të shpenzimeve për zëvendësimin e shtëpive të tyre, tokës dhe sendeve tjera, nëse ka raste të këtilla. Procedura e njëjtë zbatohet edhe për aktivitetet afariste pa marrë parasysh formalitetet.

### **Tajmingu**

Programet për zhvendosje, kompensimin e dëmit dhe për rehabilitimin e personave të prekur nga Projekti do të akordohen në mënyrë që të garantohet qasje në tokë dhe shtëpi të re para fillimit të Projektit ose të aktiviteteve ndërtimore;

Leje për pastrimin e tokës nuk do të lëshohet para se personat e prekur nga Projekti ta marrin kompensimin dhe ndihmën për rehabilitim.

### **Monitorimi**

Aranzhmane institucionale do të bëhen për monitorimin e brendshëm dhe të jashtëm të të gjitha aktiviteteve të rëndësishme në lidhje me blerjen e tokës.

### **3.3 Vlerësimi i aseteve të prekura**

Gjatë hartimit të Kornizës së Politikave për Zhvendosje, njësia për zbatimin e Projektit dhe institucioni-shfrytëzues (organi kompetent lokal ose cilado qoftë agjenci e pushtetit qendror, varësisht nga investimi), do të angazhojnë shërbime të vlerësuesit kompetent të pavarur dhe të autorizuar, përgjegjës për përcaktimin e kostos për zëvendësimin e pronave dhe aseteve. Metodologjia e vlerësimit të pronës së patundshme është përshkruar në Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 54/12)

Vlera e tregut e tokës bujqësore, pyjeve dhe kullosave përcaktohet në përputhje me çmimin mesatar të shitblerjeve të realizuara të tokës gjatë vitit të kaluar. Nëse nuk ekzistojnë shitblerje të këtilla në komunën përkatëse gjatë vitit paraprak, si vlerë e tregut do të konsiderohet kompensimi mesatar i eksproprijimit për m<sup>2</sup> të tokës bujqësore në komunë. Nëse akoma nuk ka informata për tokën e blerë dhe të eksproprijuar gjatë vitit paraprak, në komunën përkatëse, atëherë do të merren parasysh çmimet në komunat fqinje.

Gjatë procesit të vlerësimit do të konsultohen personat e prekur nga Projekti, autoritetet lokale dhe institucionet relevante qeveritare (siç është Kadastra). Pastaj, do të zhvillohen masa për kompensim dhe rehabilitim nga ana e ndërmarrjes NP për Rrugë Shtetërore në bazë të vlerësimit të përcaktuar në atë mënyrë. Parimet udhëzuese në vijim për vlerësim do të merren parasysh:

### **3.4 Vlerësimi i zëvendësimit**

3.1

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

Sa i përket tokës dhe objekteve, vlerësimi i zëvendësimit përcaktohet në këtë mënyrë:

- (i) Për tokën bujqësore, është vlera para-Projektit ose para-zhvendosjes, pa marrë parasysh se cila është më e lartë, vlera tregut e tokës me potencial ose përdorim të njëjtë prodhues e cila gjendet në afërsinë e tokës së prekur, plus shpenzimet për përgatitjen e tokës, deri në nivelin e ngjashëm me atë të tokës së prekur, plus shpenzimet e regjistrimit dhe tatimet e transferimit.
- (ii) Për tokë në afërsi të zonave të banuara, ajo është vlera e tregut para zhvendosjes nga toka me madhësi dhe përdorim të njëjtë me kapacitete të ngjashme ose më të mira të infrastrukturës publike të cilat gjenden në afërsi të tokës së prekur, plus shpenzimet e regjistrimit dhe të tatimet e transferimit.
- (iii) Sa u përket shtëpive dhe objekteve të tjera, ky është çmimi i tregut i materialeve për ndërtimin e strukturës së zëvendësuar me sipërfaqe dhe cilësi të ngjashme ose më të mira prej atyre të objekteve të prekura, ose për të riparuar objekte pjesërisht të prekura, plus shpenzimet e transportit të materialeve ndërtimore deri te kantieri, plus shpenzime për punë të tjera dhe kompensimi për realizuesit e punimeve", plus shpenzimet e regjistrimit dhe tatimet e transferimit.

Gjatë përcaktimit të shpenzimeve për zëvendësim, të cilat duhet t'u kompensohen personave të prekur me Projektin, zvogëlimi i vlerës së aseteve nuk është marrë parasysh, dhe as i vlerës së përfitimeve të cilat do të rezultojnë nga ky Projekt nuk llogariten në vlerësimin e aseteve të prekura. Kur korniza ligjore vendase e plotëson standardin e kompensimit të zëvendësimit të plotë, do të zbatohet udhëzimi i Bankës Botërore dhe specifikat teknike të kompensimit të shpenzimeve për zëvendësim.

Kompensimi i tokës, objekteve, biznesit, përmirësime fikse dhe asete të tjera të përkohshme do të mbështeten në vlerësimin e tregut, vlerësimin e produktivitetit, zgjidhjet nga negociatat, vlerësimin e materialeve dhe punës, dispozicionit të materialeve që mund të shfrytëzohen dhe në kompensime të tjera të paguara. Duhet të theksohet se mungesa e fletë-pronësisë, licencës ose lejes nuk është pengesë për kompensimin e dëmit.

## **4 Kërkesa për informata në Plan Veprimin e Shkurtuar për Zhvendosje**

### **4.1 Regjistrimi dhe inventari i personave të prekur nga Projekti**

Pas përfundimit të procedurave institucionale, për fillimin e regjistrimit dhe inventarit të personave të prekur nga Projekti, publikisht do të shpallet data e kthesës dhe atje ku është e zbatueshme do të bëhet regjistrimi i familjeve dhe personave të cilët janë prekur negativisht nga nën-komponenti. Regjistrimi do të përfshijë regjistrim të plotë të të gjitha humbjeve të çdo personi të prekur me Projektin. Kjo informatë më së paku do të përfshijë: (a) numrin e personave, nivelin e profesionit të tyre kryesor dhe lartësinë e të ardhurave; (b) numrin, llojin dhe dimensionin e shtëpive; (c) numrin, cilësinë dhe zonën e të gjitha parcelave të banimit; (ç) numrin, kategorinë, tipin dhe sipërfaqen e tokës bujqësore të cilën do ta humbas çdo person i prekur nga ky Projekt; (d) statusin e qiramarrësit të tokës bujqësore dhe lartësinë e qirasë të paguar nga qiramarrësi, aty ku është e zbatueshme; (dh) sasinë,

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

kategorinë dhe dimensionin e të gjitha ve bazë të dhëna me qira, të cilat janë prekur negativisht; (e) asete produktive të cilat janë humbur si përqindje e aseteve të përgjithshme produktive; (ë) dëmtim të përkohshëm të aseteve produktive; (i) sasinë, kategorinë, si dhe cilësinë e ekzistencës jobujqësore e cila është prekur negativisht; (f) sasinë, llojin dhe cilësinë e resurseve të bashkësisë të cilat duhet të fitohen.

### 4.2 Identifikimi i humbjeve

Nëse nën-Projekti parashikon zhvendosje fizike të personave të prekur me Projektin, do të grumbullohen të dhëna për lokacionin, sipërfaqen, tipin dhe kategorinë e tokës bujqësore, e cila është në dispozicion për qëllime rezidenciale dhe/ose bujqësore. Do të mbahet llogari që të sigurohet se vendi për zhvendosje ose toka që do të zëvendësohet është në afërsi të lokacionit paraprak të personave të prekur me Projektin, në mënyrë që të shmanget dislokimi social dhe ndarja joreale e ekzistencës ekonomike të personave të prekur me Projektin. Edhe pse bëhet fjalë për një epilog vështirë të realizueshëm. Humbjet e mundshme do të jenë në pjesën e tokës ose rrallë mund të ndodhë zhvendosje ose shpërngulje e përkohshme në vende të afërta për biznesin e vogël, pikat e shitjes.

### 4.3 Hulumtimi bazik

Hulumtimi bazik do të sigurojë të dhëna për strukturën ekzistuese shoqërore, zgjidhje për shfrytëzimin e resurseve, qasje deri te resurset në pronë të përbashkët, shërbime sociale dhe objekte infrastrukturore nga ana e grupeve të ndryshme sociale në zonën e Projektit, si dhe për popullsinë nikoqire të lokacionit të propozuar për zhvendosje (nëse është relevante), identifikimi i qartë i të gjitha grupeve speciale të interesit, veçanërisht grupet e varfra dhe vulnerabile (për shembull, qiramarrës, punëtorë pa pronë, ekonomitë familjare me kryefamiljar grua) dhe i përshkruan karakteristikat e tyre të veçanta në lidhje me Projektin. Kjo ka të bëjë me ndikimet të cilat mund të kenë epilog të këitillë, edhe pse bëhet fjalë për epilog vështirë të realizueshëm dhe do të shmanget.

## 5 Zgjidhjet për zbatim

---

### 5.1 Zhvillimi dhe procesi i miratimit të Plan Veprimit për Zhvendosje

Plan Veprimet për Zhvendosje, sipas nevojës, do të zhvillohen nga ana e njësisë për zbatimin e Projektit dhe institucionit-shfrytëzues. Përgatitja do të fillojë menjëherë pas publikimit të datës së kthesës, ndërsa aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren e përfshijnë, por nuk kufizohen, si vijon:

- Identifikimin dhe konsultimin me personat e prekur me Projektin;
- Hulumtimin dhe regjistrimin e humbjeve të personave të prekur me Projektin;
- Vlerësimin e aseteve të humbura;
- Zhvillimin e matricës për kompensim;
- Hartimin e buxhetit indikativ për zbatim.

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

Draft-Plan Veprimi për Zhvendosje do t'i dërgohet Bankës Botërore në shqyrtim dhe miratim dhe pas kësaj i njëjti mund të publikohet nga ana e Njesisë për zbatimin e Projektit për konsultime publike. Pas përfundimit të tyre, konkluzionet nga konsultimet do të inkorporohen në Plan Veprimin për Zhvendosje, ndërsa Plan Veprimi final për Zhvendosje do t'i dërgohet Bankës Botërore, kur i njëjti do të miratohet nga ana e Bankës Botërore, i njëjti do të publikohet nga ana e Njesisë për zbatimin e Projektit.

### 5.2 *5.2 Procesi i zbatimit të Plan Veprimit për Zhvendosje*

#### **Njësia për implementimin e Plan Veprimit për Zhvendosje**

Njësia për implementimin e Plan Veprimit për Zhvendosje, në kuadër të institucionit-shfrytëzues do të formohet me qëllim që të hartohen dhe zbatohen plan veprimet e miratuara për zhvendosje. Të gjitha aktivitetet e theksuara në Plan Veprimin për Zhvendosje do të mbulohen me fonde përkatëse të institucionit dhe do të përfundojnë para fillimit të aktiviteteve ndërtimore. Institucioni- shfrytëzues është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e plan veprimeve të miratuara për shpërngulje, nën mbikëqyrjen e Njesisë për zbatimin e Projektit. Banka Botërore do të ushtrojë supervizion përmes misioneve për mbështetjen e zbatimit.

Detyrimet dhe aktivitetet e shumta të Njesisë për zbatimin e zhvendosjes/Njësia për zbatimin e Projektit e përfshin, por nuk kufizohen, si vijon:

- Kontrollin e të dhënave nga regjistrimi i Plan Veprimit për Zhvendosje dhe të dhënave për inventarin e aseteve të parcelës së demarkuar;
- Realizimin, përmes nënkontraktorëve, e hulumtimeve kadastrale dhe topografike dhe sigurimin e korrekhtësisë të të dhënave nga matjet dhe inventarit ashtu siç kërkohet me ndryshimet e mundshme të disenjit;
- Konsultime të vëmendshme me personat e prekur nga Projekti dhe me përfaqësuesit e lagjeve;
- Përpilimin e dokumentacionit për regjistrimin e parcelave të reja;
- Sigurimin e informatave të nevojshme për publikun;
- Negociata dhe marrëveshje me personat e prekur nga Projekti;
- Përmeshja e kompensimit të dëmit dhe, sipas nevojës, implementimi dhe mbikëqyrja e masave për sanim. Kompensimet në para do të paguhen në llogarinë bankare të transaksionit.
- Mbikëqyrja e procedurave të ankimimit;
- Procedura gjyqësore në rastet në të cilat nuk është arritur marrëveshje;
- Procedura për eksproprijim në rrugë gjyqësore, ashtu siç kërkohet;
- Ndërtimi i infrastrukturës (në rast se nevojitet zhvendosje e sërishme) dhe zgjidhje për zhvendosjen e personave të prekur nga Projekti;
- Përgatitje të seksionit social, për çështje sociale, si dhe për çështjet në lidhje me hartimin dhe zbatimin e Plan Veprimit për Zhvendosje në raportet e rregullta të Projektit;
- Përfundimi i kënaqshëm i Plan Veprimit për Zhvendosje është kusht për çdo fillim (fizik) të punimeve.

Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

### **Ankesa dhe parashtresa**

Këto zgjidhje përcaktohen si tentativë që të evitohen, nëse është e mundur, procedurat gjyqësore, si dhe të shërbejnë si masa lehtësuese ose si resurse për personat e prekur nga Projekti.

#### Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa. Detyrat dhe përbërja

Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa, në nivel programor, do të themelohet për zgjidhjen e ankesave dhe parashtresave që kanë të bëjnë me zhvendosjen, si dhe sa u përket të gjitha mospajtimeve të cilat i janë adresuar gjykatës. Komisioni do t'i përfshijë të punësuarit në Njësinë për zbatimin e Projektit, një përfaqësues nga komunat e prekura, (ose organin përkatës të pushtetit qendror) dhe përfaqësues të bashkësisë vendore të prekur nga nën-Projekti. Ky Komision për Ankesa dhe Parashtresa do të konvokohet nga ana e Njësisë për zbatimin e Projektit edhe atë nga rasti në rast, me kërkesë ose sipas ankesës nga personi i prekur nga Projekti për zgjidhjen e ankesave dhe parashtresave që kanë të bëjnë me zhvendosjen ose me ndonjë problem tjetër shoqëror.

#### Procedura

Nën mbikëqyrjen e Njësisë për zbatimin e Projektit, institucioni-shfrytëzues do të bëjë angazhime maksimale që të arrihet zgjidhje miqësore për të gjitha problemet e identifikuara nga ana e Plan Veprimit për Zhvendosje të Projektit. Nëse kjo tentativë është e pasuksesshme, personat e prekur nga Projekti me diskrecion mund të paraqesin ankesë pranë gjykatës ose pranë Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa. Procedura e propozuar dhe mekanizmat e trajtimit të ankesave do të prezantohen dhe do të diskutohen me personat e prekur nga Projekti qysh në fazat e hershme të procesit të hartimit të Plan Veprimit për Zhvendosje. Me qëllim të grumbullimit efikas të të gjitha ankesave nga personat potencial të prekur me Projektin, mund të caktohet një lokacion konkret (dhe) për depozitimin dhe grumbullimin me kohë të të gjitha ankesave. Duke e marrë parasysh numrin e vogël të personave të prekur nga Projekti i cili pritet, kontakti me telefon është mënyrë më adekuate për personat e prekur nga Projekti. Personat e prekur nga Projekti mund të paraqesin ankesa verbale (ato dokumentohen në mënyrë përkatëse në momentin e deponimit të ankesës për lokacionin në fjalë ose përmes telefonit) ose me shkrim deri te Njësia për zbatimin e Projektit. Përgjigjja do të sigurohet në afat prej dy javësh pas pranimit të ankesës. Nëse rasti nuk zgjidhet në nivel të Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa ai mund të paraqitet në gjykatë edhe atë nga cilado qoftë palë. Çdo kompensim, i nevojshëm për këtë qëllim, do të paguhet nga Njësia për Zbatimin e Projektit pasi të konstatojnë se personi i prekur nga Projekti është shfrytëzues i ndihmës sociale në para. Të gjithë personat e tjerë të prekur nga Projekti shpenzimet do t'i kenë në barrë të tyre.

### **Procesi i eksproprijimit**

Nëse agjencia-shfrytëzuese dhe personi i prekur nga Projekti nuk arrijnë marrëveshje për fitimin e pronave private, agjencia-shfrytëzuese do të vazhdojë me procedurën e eksproprijimit, në përputhje me Kornizën e Politikave për Zhvendosje dhe Ligjin për eksproprijim.

### **Gjykata**

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

Gjykata do të jetë shansi i fundin sa u përket çështjeve dhe problemeve në lidhje me zbatimin e Kornizës së Politikave për Zhvendosje. Në rast të mossuksesit në negociatat midis institucionit-shfrytëzues dhe personave të prekur nga Projekti, që kanë të bëjnë me eksproprijimin e pronës private, Prokurori Publik (me kërkesë të institucionit-shfrytëzues) me mandat për eksproprijim në bazë të legjislacionit ekzistues deri te gjykata do të dërgojë kërkesë për eksproprijim. Pas miratimit të gjykatës dhe sipas procedurave të përcaktuara, institucioni-shfrytëzues do ta marr përsipër pronën në fjalë pasi t'i jetë dhënë e drejta e eksproprijimit nga gjykata.

Në rastet kur ankesat dhe parashtrirat për implementimin e Plan Veprimit për zbatim dhe kompensimi zgjidhen me marrëveshje, ndërkaq edhe mediacioni, nga ana e Komisionit për Ankesa dhe Parashtrira është i pasuksesshëm, personat e prekur nga Projekti do të kenë të drejtë të paraqesin ankesë deri te gjykata, si mjet të fundit. Vendimi i gjykatës është përfundimtar dhe ekzekutiv.

## 6 Mbikëqyrja dhe monitorimi

---

Aktivitetet e zhvendosjen do të mbikëqyren rregullisht dhe do të monitorohen nga ana e personelit të Njësisë për Zbatimin e Projektit në nivel të Programit. Njoftimi për monitorim të brendshëm do të kryhet si set për njoftim në nivel të Programit. Në to do të ketë pjesë për elaborimin e çështjeve sociale, përfshirë edhe rastet e mundshme të eksproprijimit të tokës/zhvendosjes. Raporti final për Plan Veprimin për Zhvendosje do t'i dërgohet Bankës Botërore. Kontrolli i brendshëm dhe mbikëqyrja do të:

- (a) konfirmojnë se është bërë regjistrimi i të gjithë personave të prekur me Projektin;
- (b) konfirmojnë se Plan Veprimi për Zhvendosje dhe hulumtimi bazë (siç është më përkatës) është i përgatitur për Projektin;
- (c) konfirmojnë se vlerësimi i pronës dhe zhvendosja është kryer në përputhje me dispozitat e këtij Programi Kornizë për Zhvendosje dhe Plan Veprimit përkatës për Zhvendosje;
- (ç) mbikëqyr se zbatohen të gjitha masat për zhvendosje në atë mënyrë siç janë miratuar;
- (d) sigurojnë se t për zbatimin e aktiviteteve për zhvendosje janë parashikuar me kohë dhe se janë të mjaftueshme për qëllimet e parashikuara dhe shpenzohen në përputhje me dispozitat e kësaj Kornize të Politikave për Zhvendosje dhe konform Plan Veprimit për Zhvendosje.

Banka Botërore do të bëjë monitorim periodik të jashtëm. Në drejtim të konfirmimit të raporteve, të gjeneruara nga monitorimi i brendshëm, monitorimi i jashtëm do të:

- (a) vlerësojë ndikimin social dhe ekonomik të zhvendosjes së personave të prekur me Projektin;

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

(b) konfirmojë se a është plotësuar qëllimi i përmirësimit ose së paku kthimin në nivelin dhe standardin e jetës të personave të prekur me Projektin; dhe

(c) aq sa është e mundur, të sigurohen propozime për përmirësimin e zbatimit të zhvendosjes në mënyrë që të sigurohet realizimi i parimeve dhe objektivave të përcaktuara me këtë Projekt dhe Kornizën e Politikave përkatëse për Zhvendosje.

## **7 Pjesëmarrja e njerëzve**

---

Siç u theksua në pjesën më lartë, personat e prekur me Projektin do të marrin pjesë në procesin e zhvillimit dhe implementimit të aktiviteteve për zhvendosje dhe në procesin e blerjes së tokës. Ata do të konsultohen nga ana e institucionit-shfrytëzues si dhe do të ftohen të marrin pjesë në takime publike, të cilat i organizon institucioni-shfrytëzues në fazat e hershme të procesit, siç u theksua më lartë. Personave të prekur me Projektin do t'u sigurohen informata relevante për Projektin, për ndikimet e tij dhe strategjitë e propozuara për zbutje dhe për aktivitete për rehabilitimin ekonomik nëse është e nevojshme. Informatat bëhen publike dhe u shpërndahen të gjitha familjeve të prekura, ndërsa të njëjtat do ta përfshijnë edhe datën e kthesës të çdo nën-projekti, kriteri për përshtatshmëri dhe të drejta, modalitete të kompensimit, si dhe procedurat e ankimimit. Palëve të prekura do t'u ofrohet mundësia e prezantimit të ideve dhe propozimeve të tyre si input për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të zhvendosjes. Të njëjtat do të arrihen përmes një sërë ushtrimesh participative dhe përmes seancave me fokus mbi personat e prekur nga projekti, me ç'rast garantohet se palët e prekura do të kenë ndikim në rezultatin e procesit.

Pas përfundimit të Plan Veprimit për Zhvendosje, personave të prekur nga Projekti nga Njësia për Zbatimin e Zhvendosjes do t'u shpërndahet një pasqyrë e shkurtër për zbatimin e zhvendosjes, në mënyrë që të vlerësohet kënaqësia e tyre nga procesi dhe rezultatet e Plan Veprimit për Zhvendosje.

## **8 Shpenzimet dhe buxhetet**

---

Buxheti vlerësuar, duke e përfshirë burimin dhe kornizën kohore do të jenë pjesë e Plan Veprimit për Zhvendosje. Të gjitha shpenzimet do të mbulohen nga institucioni-shfrytëzues ose nga ndonjë njësi tjetër për zbatimin e Projektit pranë Agjencisë qeveritare në emër të institucionit-shfrytëzues pas dërgimit të çmimit të detajuar për blerjen e tokës/zhvendosjes deri te Banka Botërore, me analizë për çdo tokë bujqësore, tokën e banimit, shtëpi, asete të tjera, si dhe asetet e prekura për ekzistencë. Shpenzimet e vlerësuara do të përfshijnë edhe shpenzime përkatëse për monitorim dhe mbikëqyrje, si dhe për shpenzime të paparashikueshme. Të gjitha shpenzimet për zhvendosje do të financohen nga fondet e institucionit-shfrytëzues.

Mes tjerash, propozohet që shpenzimet eventuale për eksproprijimin e tokës të pranohen si kontribut i aplikantit për Projektin e sub-financuar me këtë grant.

**Aneksi 1: Matrica për të drejtën e përkohshme dhe kompensim**

Kategoria e personit të prekur me Projektin	Prona	Tipi i së drejtës ose pronës apo humbjes të prekura me projektin	E drejta
Pronari (1)	Toka	Humbja e një pjese të tokës bujqësore, ndërsa pjesa tjetër e parcelës është e shfrytëzueshme	Evidentimi falas i parcelave sipas legjislacionit maqedonas, para eksproprijimit. Kompensim në para për tokën e prekur sipas shpenzimeve për zëvendësim (ekuivalent me vlerën e tregut të pronës, që është e mjaftueshme që të zëvendësohet asetet e humbura dhe mbulimin e shpenzimeve për transaksion)
Pronari (1)		Humbja e një pjese të tokës bujqësore, ndërsa pjesa tjetër e parcelës nuk është e shfrytëzueshme	Evidentimi falas i parcelave sipas legjislacionit maqedonas, para eksproprijimit. Kompensim në para për gjithë tokën e prekur me çmime për zëvendësim ose tokë parcela me madhësi dhe karakteristika të ngjashme me statusin e qiramarrësit të sigurt
Qiramarrësi (1)			Ndihmë gjatë qiramarrjes së tokës alternative/pronë për shfrytëzim të rivendosur
Pronari (1)	Pronë komerciale	Humbja e biznesit dhe/ose qirasë	Kompensim për humbjen e të ardhurave e shkaktuar si rezultat i zhvendosjes duke i përfshirë edhe dallimet në mjedisin jetësor
Pronari / qiramarrësi (1)	Kultura të përhershme	Humbja e kulturave njëvjeçare	E drejta e kulturave të drithërave ose kompensim në para për kultura njëvjeçare me vlerë zëvendësuese
Kërkesa për pronësi (2)	Toka	Humbja e tokës	Kompensim në para për shpenzimet e zëvendësimit të tokës së prekur
Nuk ka të drejtë të njohur ligjore ose kërkesë (3)	Toka dhe asete të tjera	Humbja e tokës dhe aseteve	Nuk ka kompensim në para për shpenzimet e zëvendësimit të tokës së prekur. Kompensim në para për shpenzimet e zëvendësimit të prekur



Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

## ***Aneksi 2: Lista për kontrollin e informatave nga regjistrimi***

### **Persona:**

- Numri i përgjithshëm i individëve dhe ekonomive familjare të çdo kategorie të prekur;
- Moshë, gjinia, profesioni i çdo individi.

### **Prona**

Pronë personale duke përfshirë edhe të dhëna për pronësinë e:

- objekteve: shtëpi, objekte bujqësore, dyqane, objekte industriale, sipërfaqe për tharjen e drithërave, tualete;
- tokës dhe llojit: Të ujitur ose të pa ujitur, zona pyjore, kullosa, djerrina, etj.;
- përshkrimi dhe vlerësimi i vlerës së kulturave ekzistuese të tokës;
- të tjera: bagëti, puse, pemë.

### **Pronësia publike dhe e përbashkët:**

- tokë Sipërfaqe të përbashkëta për gjithë fshatin, hapësira për tubime dhe ushqim, zona peshimi, etj.;
- objekte dhe kapacitete: shkolla, institucione shëndetësore, varreza dhe tempuj, qendra të bashkësisë, transporti publik, banka, kooperativa;
- infrastruktura: Sisteme për ujë të pijshëm dhe ujëra të tjerë, rrugë për hyrje-dalje dhe interne, energjia elektrike dhe burime tjera të energjisë;

### **Të ardhura nga burime të tjera të personave të prekur me Projektin, duke përfshirë:**

- Të ardhurat nga ferma;
- Të ardhura nga puna jashtë fermës;
- Të ardhura nga aktivitetet në sektorin joformal.

***Aneksi 3: Lista e të dhënave për hulumtim gjatë regjistrimit***

**1. Informata themelore**

- (a) Shifra e pyetësorit dhe data e hulumtimit
- (b) Emri i personit që e ka bërë intervistën
- (c) Emërtimi i rajonit, zonës dhe fshatit

**2. Regjistrimi i ekonomive familjare**

- (a) Emri i kryefamiljarit dhe të të gjithë anëtarëve të ekonomisë familjare
- (b) Raporti i anëtarëve të ekonomisë familjare me kryefamiljarin
- (c) Mosha dhe gjinia e secilit anëtar të ekonomisë familjare
- (ç) Informata për përkatësinë etnike
- (d) Niveli i arsimit të çdo anëtari
- (dh) Profesioni kryesor dhe të ardhurat mujore për çdo anëtar
- (e) Të ardhura nga burimet sekondare për çdo anëtar
- (ë) Vendi i punës ose biznesit sido që të jetë rasti
- (f) Kohëzgjatja e qëndrimit në lokacionin aktual

**3. Statusi i qiramarrësit**

- (a) Kategoria e tokës
- (b) Lloji i pronësisë mbi tokën dhe emri i pronarit/anëtari i ekonomisë familjare.
- (c) Lloji i dokumentit në posedim që të konfirmohet lloji i pronësisë
- (ç) Nëse nuk është në pronësi të tyre, emrin dhe adresën e pronarit
- (d) Lloji i marrëveshjes, nëse kanë të drejtë të drejtë të përdorimit joformal
- (dh) Numri i viteve që është në përdorim
- (e) Qiratë mujore të paguara nga qiramarrësit
- (ë) Depozita të krijuara nga ana e shfrytëzuesit

Vërejtje: Në rastin kur regjistrimi dhe inventari konsiderohen si ushtrime të veçanta, disa informata për shfrytëzimin e tokës, struktura të prekura dhe asete të tjera themelore, biznese të prekura, gjithashtu duhet të grumbullohen si pjesë e hulumtimit të regjistrimit.

***Aneksi 4: Lista e të dhënave për regjistrimin e humbjeve***

**1. Shfrytëzimi i tokës**

- a. Dedikimi ekzistues i tokës
- b. Zona për shfrytëzim të ndryshëm të tokës, aty ku është e zbatueshme
- c. Zona e përgjithshme dhe e prekur e tokës me analizë aplikative, nëse është e aplikueshme
- ç. Vlerësim për shfrytëzimin e zonës tjetër për shfrytëzim të vazhdueshëm
- d. Sipërfaqja e përgjithshme e tokës sipas tipit për qëllimet e kompensimit

**2. Objekte:**

- a. Tipi i strukturës
- b. Numri i kateve
- c. Sferat sipas kateve
- ç. Emri i pronarit të objektit
- d. Viti i ndërtimit
- dh. A ekziston leja e objektit
- e. Përdorimi i objektit dhe fusha aplikative, nëse është e aplikueshme
- ë. Përshkrimi i materialeve ndërtimore të cilët përdoren për çati, mure dhe dysheme
- f. Lloji i bazës
- g. Përshkrimi i disa karakteristikave të veçanta të strukturës
- gj. Koneksione të reja (njehsorë të energjisë elektrike, ujit, etj.)
- h. Kompensime të paguara për lidhje komunale
- i. Zona rreth objektit e cila është e prekur
- j. Vlerësim për shfrytëzimin e objekteve të tjera për shfrytëzim të vazhdueshëm

Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

k. Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtesës për kompensim

### **3. Struktura të tjera**

a. Lloje të strukturave (puse, mure rrethues, gardhe, magazina, etj.)

b. Sipërfaqja rreth basenit të prekur të peshqve

c. Të ardhura mesatare të ekonomive familjare nga baseni i peshqve

d. Përshkrimi i sferave dhe materialeve ndërtimore të objekteve të prekura

dh. Përdorimi i strukturave të tjera

### **4. Produkte bujqësore**

a. Lloji i kulturave të prekura

b. Pronari i kulturave të prekura

c. Prodhimi i përgjithshëm vjetor i kulturës në tokën e prekur

ç. Rendimenti mesatar nga kultura

d. Të gjitha produktet që shiten në treg

dh. Numri i të punësuarve/ fuqia e punës e cila përdoret për prodhimin e kulturave bujqësore

e. Vlera mesatare e kulturave

ë. Të ardhurat mesatare vjetore të ekonomive familjare nga bujqësia

### **5. Pemë**

a. Numri dhe lloji i pemëve të prekura

b. Moshja e pemëve

c. Emri i pronarit të pemëve

ç. Rendimenti mesatar i pemëve frutore

d. Të ardhurat mesatare vjetore nga pemët frutore

## **6. Biznesi**

- a. Lloji i biznesit të prekur
- b. Emri i pronarit të biznesit
- c. Regjistrimi/numri i lejes së biznesit (kontrolloni dokumentet)
- ç. Të ardhurat e përgjithshme vjetore të ekonomive familjare nga biznesi
- d. Shpenzimet mesatare operative të biznesit
- dh. Numri i të punësuarve në biznes
- e. Numri i punësimeve të përhershme dhe të përkohshme
- ë. Të ardhurat dhe profiti mesatar siç është deklaruar për tatimin mbi fitim (kontrolli i dokumenteve)
- f. A duhet të zhvendoset biznesi

## **7. Veprimtari dhe objekte komunale të prekura**

- a. Përshkrimi i infrastrukturës së prekur në bashkësi
- b. Përshkrimi i objekteve të prekura sipas sipërfaqes dhe materialit ndërtimor i cili përdoret
- c. Përqindja e numrit të popullsisë e cila negativisht është prekur nga objektet/infrastruktura

## **8. Përparësi për zhvendosje**

- a. A ekziston nevojë për zhvendosje ose riorganizim
- b. Mënyra e preferuar e kompensimit (monetare apo jomonetare) për tokën
- c. Mënyrë e preferuar e kompensimit të strukturës
- ç. Lloji më i preferuar i ndihmës për sanimin e të ardhurave

## Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

Shënim: Informatat përfundimtare, statusi i ekonomive familjare dhe shfrytëzimi i tokës do të jetë njëloj si në Aneksin 4: Lista e të dhënave për hulumtim gjatë regjistrimit

Informatat plotësuese do ta përfshijnë, si vijon:

### **1. Hyrje-dalje tek objektet**

- a. Qasje deri te energjia elektrike
- b. Lloji i furnizimit me ujë i cili është në dispozicion
- c. Lloji i nyjave sanitare në objekt
- ç. Distanca nga shkolla
- d. Distanca nga institucionet shëndetësore
- dh. Distanca deri te tregu

### **2. Asetet e ekonomisë familjare**

- a. Lloji dhe numri i pajisjes bujqësore dhe aparateve në pronësi të ekonomisë familjare
- b. Lloji i pajisjes tjetër afariste në pronësi të ekonomisë familjare
- c. Vlera e vlerësuar e pajisjes së prekur
- ç. Lloji i mjetit transportues në posedim (biçikletë, motor, kamion, karrocë për kafshë, automobil, etj.)
- d. Pajisje të mëdha për kuzhinë në pronësi (sobë, shporet, etj.)
- dh. Pronësi: frigorifer, radio, televizion, etj.
- e. Gjendja e përgjithshme e objektit (e shkëlqyeshme, e mirë, mesatare, e keqe)
- ë. Gjendja e përgjithshme e pajisjes së ekonomisë familjare (moblie, dollapë, etj.)

### **3. Të ardhurat dhe shpenzimet e ekonomisë familjare**

- a. Të ardhurat mesatare vjetore të ekonomisë familjare nga të gjitha burimet
- b. Konsumi mesatar i zërave kryesore: ushqim, transport, shëndetësi, arsim
- c. Kredi e marrë nga banka, miq ose familjar
- ç. Kursime, nëse ka

Korniza e Politikave për Zhvendosje (KPZH)

4. Aftësitë të cilat i posedon

a. Aftësitë e çdo anëtari të ekonomisë familjare

b. Llojet e trajnimeve ose shkathësive më të dëshiruara për mbindërtimin e mëtutjeshëm.